



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 03.12.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: **Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese, anëtarët e Komitetit: **Ramadan Salihu, Gyltene Retkoceri, Jeton Tanhasi dhe Ermira Shabani**.

Munguan: **Mehreme Llumnica dhe Armend Ademi**.

Të pranishëm ishin edhe: **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës, **Premtime Preniqi**, koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut, **Behxhet Shala -KMDLNJ**, **Leonora Shabani - Bajraktari**, **Cenë Krasniqi**, **Elona Gashi dhe Trëndafille Salihu**.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese me këtë

### REND DITE :

#### 1. Shënimi i Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderojë për pjesëmarrjen në këtë organizim të Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara të Komunës së Prishtinës, i cili organizim i dedikohet 3 dhjetorit - Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara.

Ne si Komitet jemi të konsoliduar që për dy mandate kemi dhënë maksimumin mbi eksperiencën tonë, kemi dhënë kontributin për persona me aftësi të kufizuara dhe për këtë u jemi mirënjohës: Institucioneve komunale; Shoqatave të komunitetit të aftësisë së kufizuar - për bashkëpunim; Organizatave dhe institucioneve tjera - për mbështetje, si dhe individëve, persona me aftësi të kufizuara, - për rritjen e interesimit për Komitetin dhe punën e tij.

Komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuara i Komunës së Prishtinës është themeluar më 26 korrik 2016, në përbërje prej pesë anëtarëve, njohës të paaftësive: verbërisë, shurdhërisë, paraplegjisë/tetraplegjisë, daun sindromit dhe autizmit. Ndërkaq në mandatin e dytë, me vendim të Kuvendit të Komunës, të datës 29 korrik 2019, Komiteti kalon në përbërje prej shtatë anëtarëve.

Objektivat bazë të këtij komiteti janë nxitja, mbrojtja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë PAK në territorin e Komunës së Prishtinës t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe sa i përket domenit të nivelit komunal të qeverisjes.

E tërë puna dhe veprimtaria e Komitetit për periudhën mandatore, në aspektin dinamik varet nga koha e shtruarjes së çështjeve tematike nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës, komitetet e përhershme, si dhe vetë Komiteti, e të cilat tema janë:

- Dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës apo komitetet e përhershme në fushat përkatëse;
- Paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve, PAK tek Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës; si dhe
- Propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Komiteti është i hapur dhe mirëpret bashkëpunimin me faktorë tjerë shoqëror më të specializuar në këtë lëmi dhe donatorë projektsh zhvillimore për PAK.

Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Prishtinës, Komiteti mban katër mbledhje të rregullta në vit dhe dy tjera eventuale.

Përveç mbledhjeve, Komiteti ka pasur edhe takime me përgjegjësit digasterial të drejtorive komunale, si dhe ka ndjekur një trajnim në kuadër të projektit "Më shumë përfaqësim për PAK".

**Selim Pacolli**, tha se jam i privilegjuar që jam këtu para jush që të diskutojmë dhe ti shohim mundësitë e bashkëpunimit se si mundemi ti vijmë në ndihmë, në mbështetje të kësaj kategorie të shoqërisë e cila rrjedh pikërisht nga vetvetja jonë. Unë çdo ditë ballafaqohem me kërkesa të tilla që kjo kategori e shoqërisë tonë kanë probleme akoma në qasje në objektet e tyre. Nuk kanë pjerrina në objektet publike, nuk kanë infrastrukturë të mjaftueshme e mos të flasim për objekte private kudo që ndërtohen që është obligim i yni të bisedojmë me drejtorët që japin leje ndërtimi se nuk shikohet asnjëherë çështja e qasjes së kësaj kategorie nëpër këto objekte, kështu që ne jemi të detyruar edhe me ligj edhe me norma edhe me rregullore të Komunës që ti vijmë atyre në ndihmë kur dihet se ne kemi 10% të popullatës. Ne në komunën tonë i kemi 2 PAK, kur dihet faktikisht se duhet me pas 1/50 me ligj.

**Vasilika Zotaj** tha se në të gjitha objektet janë 13 PAK të punësuar, e vetëm këtu në objekt janë 2 të punësuar.

**Selim Pacolli** po ashtu cekti se për kategorinë që janë të prekur me Sindrom Doun kemi ofruar një lokal pa pagesë që kanë qasje direkt, nuk kanë nevojë për rampa në lagjen "Pejton" dhe është ndërtim e sipër objekti i ri të "Stacioni i autobusëve". Unë mund të zotohem në cilësinë e nënkryetarit çdoherë e keni të hapur derën për çfarë do kategori të PAK që ka nevojë të ketë mbështetjen time dhe për çfarë do bashkëpunimi.

**Behxhet Shala** tha se është bërë si rregull në Kosovë që çdo grupacion të ketë një ditë që shënohet dhe të gjithë mendojmë që sot e shënojmë ditën e PAK dhe këtu përfundon detyrimi dhe pastaj nuk merremi me të ose fare pak. Më parë u cek se është Deklarata univerzale e të drejtave të njeriut e cila rregullon çështjen e univerzitetit aty nuk ndahen as të drejtat e PAK, as fëmijëve, as pakicave po të drejtat e rritjeve univerzale ato i takojnë çdo personi. Tash ligji e rregullon shumë mirë statusin e PAK-ra, nuk ka asnjë dilemë, nuk është një ligj por një pako e ligjeve që rregullon Konventën Ndërkombëtare për PAK, cilët janë këta persona, cilat të drejta i takojnë mirëpo nga e shkruara deri te e bëra është një rrugë e gjatë. Po ceku se të gjithë PAK kanë probleme në Kosovë në radhë të parë janë të stigmatizuar ndonëse kjo nuk shprehet fort por realisht askush kur ka punë për me i punësuar PAK. Kjo kategori nuk merret parasysh se këta kanë kapacitet më të fortë se na, mundë të kryejnë punë ma shumë se na, por gjithmonë i vënë në mënyrën e mëshirës e rrallë për afërsisht që e ka plotësuar normën ligjore e cila parasheh sa persona në Kosovë prej kësaj kategorie duhet mu punësuar. Jemi shumë keq ndoshta edhe shoqëria duhet të bëjë më tepër, Prishtina është kryeqytet i Kosovës dhe nuk duhet të krahasohet me komunat tjera i takon se gjitha fuqitë ekonomike-politike, administrative etj janë të përqendruara dhe i ka mundësitë më të mëdha.

Sa i përket parkingjeve ka shumë pak parkingje për PAK, madje parkingu kryesisht përdoret nga persona tjerë e këtu duhet me pas një bashkëpunim me Policinë e Kosovës ata me përcjell që ata mu kujdes ma shumë për parkingjet. Tani Komuna e Prishtinës e ka një plan për me bërë njëfarë riorganizimi të parkingjeve mendoj duhet të rritet kapaciteti i parkingjeve për PAK dhe shtroi pyetjen se a janë të liruar nga pagesa.

**Vasilika Zotaj** tha se janë të liruar nga pagesa e parkingjeve PAK.

**Behxhet Shala** tha si Këshill kemi qenë në fushatë të Kosovës për sensibilizimin e PAK, kemi bërë identifikimin edhe të pjerrinave dhe pengesave dhe kemi dal me rekomandime se mund t'ju ndihmojmë në trajtimin e tyre, mirëpo implementimi i atyre pjerrinave ka qenë shumë i vogël se janë arsyetuar nuk kanë plan. Po ashtu autobusët e rinj që kanë ardhur nuk i plotësojnë kushtet për këta persona edhe në aspektin e shërbimeve shëndetësor kanë probleme se qasja është ndoshta kushti kryesor i cili u mundëson apo ju pa mundëson shkollimin dhe shëndetësinë dhe lëvizjen e lirë. Në këtë drejtim duhet me punuar ma shumë që me pasur njëfarë lehtësimit prej Komunës apo institucioneve tjera të nivelit qendrorë në mënyrë që të punësojnë numër më të madh të PAK. Komuna e Prishtinës është ma mirë se Komunat tjera por, nëse bëjmë krahasimin me vendet tjera larg jemi.

**Vasilika Zotaj** tha se edhe pse nuk kam pasur informacione shumë për këtë kategori me ndihmën e Premtimes i kam marrë informacionet e duhura siç funksionon PAK në Komunën e Prishtinës. PAK e përbëjnë më shume se 10% të popullatës në Komunën e Prishtinës kjo është një statistikë prej punës së Planit të punës së PAK-ra të cilën në një formë apo tjetrën janë diskriminuar në shfrytëzimin e shërbimeve. PAK në qytet ende nuk mundën me qarkulluar lirshëm dhe të kenë qasje në të gjitha shërbimet që ofron qyteti edhe pse ne si komunë mundohemi me ju krijuar kushte por, ende nuk janë të kënaqshme. Jemi të vetëdijshëm se ligji e parasheh 1/50 të punësohet një PAK, e në asnjë institucion nuk kemi arritur të realizohet duke ditur se punësimi për gjithë personat është një problem i madh shumë, ne si shoqëri e kemi obligim me ju dal në mbrojtje PAK. Kemi një zotim që të gjithë institucionet komunale dhe profesionistët me mandat për mbrojtje të PAK, të koordinohen

edhe të ndërmarrin gjitha veprimet për ofrim të shërbimeve edhe pse jemi të vetëdijshëm se ato ende nuk janë të mjaftueshme. Ne si Komunë kemi bërë përmirësimin e infrastrukturës së brendshme komunale, ku kemi rregulluar liftin dhe pjerrinën gjithashtu e njëjta gjë ka shkuar edhe në QMF-të ku Drejtoria e Mirëqenies sociale i ka ofruar lokale në NPB dh ju ka larguar qiranë e lokalit dhe subvencione, organizimi i seminareve dhe trajnime të ndryshme me qëllim të vetëdisimit të shoqërisë. Krijimi i KKPAK është një mekanizëm për të ngritur problemet e PAK, e drejta për kujdes shëndetësor falas. Në vitet e fundit Komuna e Prishtinës ka krijuar një standart të këndshëm për kujdesin shëndetësor nëpër QMF-të, ku Komuna zbaton ligjin përmes "Trafikut Urban" për pagesën falas për transport të PAK.

Derisa sa të shohim PAK në rrugë derisa dëgjojmë se PAK se janë viktimat të shfrytëzimit dhe numrit të vogël të punësimit, ne asnjëherë nuk do të jemi qetë, andaj të ngrejmë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe nivel qendror, ta ngrejmë bashkëpunimin me organizata të ndryshme për mbrojtjen e PAK dhe ta ngrejmë vetë dijen e shoqërisë për mbrojtjen e këtyre të drejtave pa integrim të plotë të PAK në shoqëri, në tregun e punës, arsim, shëndetësi, shkencë, kulturë, politikë etj.

Shteti përmes politikave sociale duhet t'ia garantoj zhvillimin, mirëqenien dhe edukimin e çdo personi.

**Selim Pacolli** tha se për parkingjet është e vërtetë se ne kemi në Plan të mobilitetit ku ka filluar me u bërë implementimi në zonën e parë të qytetit, jemi duke implementuar shkallët dhe pjerrinat dhe sigurimi i parkingjeve për këtë kategori të shoqërisë.

**Premtime Preniqi** tha se më vjen mirë që jam pjesë e këtij grupi të Komiteti për PAK, është me të vërtetë një komitet që po funksionon dhe është mandati i dytë.

Edhe ne si shtet që 20 vite pas luftës vendi ynë ende ballafaqohet për ti ardhur në ndihmë PAK për t'ju barazuar atyre mundësitë dhe për të qenë të integruar me qëllim që PAK të mundë të jetojnë të barabartë, ku ata duhet me pasur edhe qasje si në infrastrukturë dhe në shërbimet shëndetësore, sociale ndoshta edhe te teknologjia si dhe të ndihmat e ndryshme. Është një hendikep që shoqëria jonë nuk po e merr parasysh gjithë këto organizata të PAK të cilat janë, nuk i thërret në takime dhe gjatë atyre planeve të cilat bëhen mi marrë parasysh edhe kërkesat e tyre.

Po ashtu ceku se çështja e parkingjeve është pjesë që është në proces dhe do të jetë si rekomandim që të jetë parasysh që parkingu të bëhet dhe si pjesë e veçantë me qenë e ndarë si nëpër vendet evropiane që është pjesë e ndarë dhe nuk mundet askush ta shfrytëzon.

Sa i përket PAK përveç këtyre qasjeve kemi edhe gjithë përfshirjen në arsim, gjithë përfshirja në arsim nuk është problem i brendshëm i nivelit lokal, por i nivelit qendror dhe gjithë përfshirja parasheh kuadrin arsimor, kabinetin dhe shumë gjëra tjera.

Sa i përket qasjes në institucionet shëndetësore për momentin Komuna e Prishtinës është me një nivel më të mirin krahasuar me komunat e tjera të Kosovës, mirëpo edhe këtu është një hendikep, pasi që niveli qendror nuk i përmbush kriteret me barnat esenciale për PAK e mos të flasim kur janë pagesat për PAK ku janë ato shërbimet tjera sociale. Ka disa lloje të aftësive të kufizuara që me të vërtetë kanë nevoja ma shumë mirëpo aty stopohen ku edhe nuk mundën me i krye. Komiteti që ka punuar në Komunën e Prishtinës me të vërtetë është një shembull i mirë që një organizim, një mekanizëm brenda komunal ka kryer një punë shumë të mirë.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se unë mund të flas më shumë për gjithë përfshirjen në arsim për të drejtat e fëmijëve e në fokus për aftësinë e kufizuar. Sa i përket infrastrukturës shkollore asnjë shkollë në Komunën e Prishtinës që duhet me qenë si shembull e komunave tjera nuk kemi lifta për fëmijët në karroca dhe e kanë të pa mundur mi ndjek lëndët e ndryshme në kabinete.

Gjithashtu Komuna ka pasur mundësi prej vitit shkollor të kaluar mi punësuar 12 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta dhe nuk e ka bërë këtë punë për shkak të një gabimi në linjat buxhetore ku kjo kishte mundur mu rregulluar dhe mu punësuar vitin e kaluar. Gjithashtu as niveli komunal e as ai qendrorë nuk ju kanë kushtuar rëndësi në përgjithësi fëmijëve, po ashtu edhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjithashtu prindërit e PAK ankohen për pagesën e transportit, ku niveli komunal e bënë me vonesë pagesën e transporti. Po ashtu niveli komunal ka marrë një lloj vendimi që me i paguar prindërit e ato nuk paguhen me kohë. Deri më tani nuk është bërë asgjë për fëmijë me nevoja të veçanta, secili fëmijë me nevoja të veçanta ka nevojë për fizioterapi, asnjë komunë në republikën tonë nuk e ofron, secila nënë që lind fëmijë me nevoja të veçanta ka nevojë për këshilla për këshillimore, po ashtu asnjë komunë nuk të ofron logopedin. Psikologun që e kemi në shkolla as nuk e konsideroj psikolog , kemi 3-4 shkolla nuk kanë hiq psikolog në komunat qendra janë tre psikolog dhe një psikolog në tri shkolla. Komuna e Prishtinës mundet me bërë me kontratë mbi vepër edhe punësimin e psikologut nëpër shkolla po ashtu logoped edhe për mësuesit mbështetës njëjtë me bërë edhe për asistent për fëmijë me nevoja te veçanta.

**Selim Pacolli** tha se asnjë komunë tjetër as niveli qendror nuk është për t'ju gëzuar kurrfarë iniciative të cilën e kemi marrë e kemi obligim, duhet të kemi një çasje ma humane ndaj kësaj kategorie ne duhet me gjete forma tjera ligjore me i mbrojtur me ligj qoftë me një rregullore të brendshme të Komunës.

**Ramadan Salihu** tha se ne si Komitet po mundohemi sa kemi mundësi me sensibilizuar çështjen e PAK. E parashtroj pyetjen mbi komentin tim paraprak do të thotë a ka bërë Komuna e Prishtinës për PAK , ne mund të themi se ka bërë madje edhe ka bërë shumë a e ka bërë kryesoren jo nuk e ka bërë, kryesorja këtu është integrimi i PAK në shoqërinë ku jetojmë në qoftë se kryeqyteti ngec në integrim atëherë çfarë të presim nga viset tjera provinciale apo rurale, e ne si Komitet dhe si komunitet në përgjithësi kemi kërkesa ligjore. Kanë kaluar 11 vjet që në konsensus shoqëror në nivel kombëtar me miratuar legjislacionin edhe asnjë PAK bazuar në dispozita ligjore nuk është punësuar qysh e kuptojmë atë integrimin e PAK.

PAK në Republikën e Kosovës nga shoqëria është i izoluar ka disa PAK nëpër struktura të OJQ-ve e di si janë punësuar por jo në baza legjislative.

Po ashtu ceku se e kanë bërë një Planë të veprimt për PAK i cili është miratuar në Asamble Komunale me 38 vota ku u premtua se deri në vit të ri 5% të këtyre personave me i punësuar, por kaluan dy vite e gjysmë nuk u punësua asnjë person.

Ai i parashtroi pyetje zotëri Behxhet Shalës, ne për PAK e kemi ligjin dhe ky ligj është aprovua mbas ligjit për shërbyes civil dhe mbas Ligjit të punës dhe tani këto ligje janë të përgjithshme, kurse Ligji i PAK është miratuar mbi bazën e asaj që nuk kanë mundur ato ligje mi ingranu mbi veti gjitha dispozitat çka i bëhen krejt kësaj shoqërie njerëzore dhe a është ky legjislacion ligji special e përjashton ligjin e përgjithshëm në rastet konkretë siç është punësimi që po flasim a është obligative nëse nuk është obligative kisha dashur komentin tuaj si

institucion i pavarur që merreni me të drejtat e njeriut, avokatit të popullit me na u përgjigj, pra pyetja ime është a është obligative dispozita kur ta përcakton kur të thotë: neni 12 çdo punëdhënës në Sektorin publike dhe privat, çdo OJQ është e obliguar që në çdo 50 punëtor ta punësoj një PAK, mund ta gjeni edhe dispozitën.

**Behxhet Shala** u përgjigj duke cekur se ligjin duhet me zbatuar se ligji që nuk zbatohet i ka pasojat. Është e vërtetë se në çdo të 50 të punësuar duhet të punësohet një PAK, mirëpo nuk po zbatohet ligji as për së afërmi, nuk i përmbush obligimet ligjore që në çdo 50 të punësuar me qenë një PAK për këtë thash sa ka në Komunën e Prishtinës ka por pak janë. Po më intereson Komuna e Prishtinës a keni ndonjë mekanizmi monitorues që e monitoroni gjendjen e PAK në Komunën e Prishtinës, a dilni në terren ku ka probleme, ku ka pengesa apo vetëm në bazë një raporti që e merrni këtu, a ka mekanizëm.

**Premtime Preniqi** tha se sa i përket Ligjit për PAK është e vërtetë se ligji nuk është duke u respektuar, mirëpo nuk mundemi me u arsyetuar askush se nuk kemi qasje të duhur. Ne kemi PAK që e kanë fakultetin, masterin ndoshta edhe doktoraturën, por atyre nuk ju mungon qasje për arsye ndoshta ata kanë ndonjë problem të vogël dhe kanë aftësi intelektuale dhe aftësi të lëvizjes, se kemi lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara sipas mundësive që kemi mundemi me marrë një PAK.

**Cenë Krasniqi** falënderoi për organizimin e këtij takimi se së paku po i shprehim mos të them sikurse institucionet vetëm po rrëfen e mjerisht ato janë të bllokuara me vazhdua, mu krye.

Unë vij nga autizimi, për katër vite së bashku me Sindrom daun i kemi mbledhur ma shumë se 200 mijë euro na është premtuar lokacioni për objekt pastaj doli që OJQ nuk munden me marrë lokacion por komuna do të bashkë investoj dhe do ta bëj këtë objekt. Lidhur me këtë objekt gjysma e asambles ishin që a duhet me qëndrua vetëm për autizëm dhe sindrom daun apo për të gjitha llojet e nevojave të veçanta dhe doli tenderi ideor për shkak të ankesave sot e kësaj dite nuk është aktiv e në ndërkohë u paraqit "Tika" si bashkë investitor dhe me ndihmën tonë do ta ndërtojmë këtë objekt ku dhe komuna e ka përcaktuar lokacionin.

Ne kemi punuar në një objekt pa kushte të volitshme, mirëpo Komuna na ka dhënë në shfrytëzim shtëpinë e shëndetit në Dragodan jemi shumë falënderues. Kemi një problem tjetër se me një hapësirë janë edhe fëmijët e vegjël dhe të rritur dhe është një mundësi e mirë se aty është një hapësirë që mundet me u shfrytëzuar mirëpo qe 4-5 muaj nuk po mundem të takohemi me zyrtar kompetent të komunës dhe me marr përgjigje, pra përderisa ai objekt është pronë e Drejtorisë së shëndetësisë. Unë i kuptoj kur nuk mundet mu siguruar pjerrina për rampa në ndonjë objekte apo kërkohen investime të madhe, mua po më pengon kjo çështja irituese kur diçka shumë lehtë mundet me u bërë e nuk bëhet.

Problem kryesor te ne autizmi është nëse punojmë me fëmijë prej moshës 2 vjeçare dhe me programe të mirëfillta ai fëmijë del gjegjësisht në nivel të caktuar rehabilitohet dhe bëhet kontribues i shoqërisë nëse nuk punojmë me ta prej fëmijërisë atëherë ai mbetet barrë për gjithë shoqërinë në të ardhmen.

Kemi problemin e arsimit, kanë qenë disa shkolla që kanë pasur klasë të bashkangjitura ato fillimisht por nuk kanë funksionuar siç duhet dhe ndërkohë është vendosur me u mbyll mirëpo kësaj klase është dashur me pas secilën shkollë.

Sa i përket parkingjeve na duhet me kuptuar se duhet me u zgjidh me një plan më global, duhet me u funksionalizuar transporti i autobusëve, me u rrit numri i parkingjeve, po ashtu sa i përket tualeteve dhe rampave lirshëm mundem me thënë shumë elemente të Universitetit të Prishtinës nuk i kanë këto kushte, nuk i plotësojnë.

Po ashtu tha se komuna ka hap tender për transportues të fëmijëve me nevoja të veçanta, ku janë paraqitur 12 fëmijë, kurse prindërit e fëmijëve tjerë ishin deklaruar po qe mundet me kompensim, kompensimi ka qenë që operatori prej Komunës me i marr 1 euro për fëmijë për km., kurse ai familjes ja kompenson 40-50 cent për km, pra kjo çështje ka mbetur pa u specifikuar dhe nuk është realizuar.

**Jeton Tanhasi** ceku çështjen e liftave, ku ndërtimtaria para luftës ka mundësua me u bërë ndërtesat deri në katin e 4-5 pa lift ky është problem i të gjithëve jo vetëm i Prishtinës por në tërë Kosovën, se në atë ndërtesa kemi PAK, kemi persona të moshuar, me sëmundje të rënda kështu që është një problem shumë i shprehur në shoqërinë tonë.

Në lagjen "Dardania" unë e kam bërë liftin, ju kam drejtuar Komunës më kanë dhënë lejen për atë lift, kam aplikuar në Komunë më kanë refuzuar nuk mu kanë përgjigjur aty ka qenë një shumë simbolike 2.000 euro dhe unë e kam bërë me forcat e mia. Ky është problem i personave që jetojnë në ndërtesat e larta të ndërtesave të vjetra, duhet shoqëria me analizuar këtë çka me bërë, a ka me ju mundësua me lejua leje dhe me ju ndihmuu materialisht.

Sa i përket parkingjeve unë kam kërkuar në Komunë që në lagjen "Dardani" janë 200 parkingje që njëri prej parkingjeve me u bërë për PAK, andaj dhe mu ka refuzuar kërkesa.

Komuna e Prishtinës i ka dhënë tender për mirëmbajtje të liftave në Prishtinë në kuadër të atij tenderi mundet me dhënë njëfarë kontributi, një lloj donacioni për ndërtimin e liftave nga ana e jashtme dhe me ja qit si kusht se Komuna dhe Qeveria kanë mundësi se nuk ka shumë objekte të tilla.

**Selim Pacolli** tha se ne e kemi marrë një vendim që e kemi angazhuar NP-Banesore dhe që jemi të obliguar në bazë të një projekti për rigjenerim në kuadër të investimeve brenda hapësirave kolektive të cilat janë mundësitë e shtrirjes së pjerrinave po edhe të ashensorëve në te cilat është e mundur dhe ekipet e kësaj ndërmarrje janë në terren duke punuar.

**Premtime Preniqi** tha se sa i përket çështjes së liftave tash për momentin në bashkëpunim me NP-Banesore është një procedurë ku pjesën e strukturës së jashtme e investojnë qytetarët, liftin dhe mirëmbajtjen e bënë NPB-ja. Këtu është pak hendikep për arsye se ne si qytetarë procedurat që duhet me i marrë nënshkrimet prej 20 banorëve duhet minimumi 18 nënshkrime me i marrë e qytetarët nuk janë të interesuar se aty sillet 500-600 euro që duhet mi dhënë secili banorë për me zgjidhë këtë çështje.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese i falënderoi të pranishmit për kontributin e dhënë në këtë tryezë për Ditën ndërkombëtare, ditën e 3 dhjetorit e cila shënohet për PAK.

Në bazë të diskutimeve, Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nxori këto

## REKOMANDIME

1. Zbatueshmëria e Ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara ne nivel lokal.

Faqe 7 nga 8

2. Punësimi i asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
3. Rregullimi i toaleteve në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuara.
4. Qasja në autobusët për personat me aftësi të kufizuara dhe pa pagesë.
5. Parkingjet të ndahen dhe shenjzohen për personat me aftësi të kufizuara.
6. Rregullimi i Infrastrukturës në Institucionet arsimore për fëmijët/nxënësit, personat me aftësi të kufizuara.
7. Rregullimi dhe mirëmbajtja e liftave dhe pjerrinave për personat me aftësi të kufizuara.
8. Punësimi i stafit profesional në shkolla: Psikolog, Logoped etj.
9. Trajnimi i mësimitdhënësve mbi nevojat e veçanta arsimore të fëmijëve.

*Mbledhja përfundoi në orën 12:00.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesja e Komitetit**  
**Fatime Demolli - Mustafa**

